



Universiteti i Prishtinës “HASAN PRISHTINA”
Fakulteti i Ndërtimtarisë

Vizioni, Strategjia jonë. 2021 -2023



Prishtinë, Korrik 2021



Vizioni, Strategjia jonë. 2021-2023

Përmbledhje

Ky plan strategjik përfshinë ambicet kolektive dhe imagjinatën e stafit tonë, studentëve dhe administratës duke përfshirë Alumnin, mbështetësit, bashkëpunëtorët tanë. Është një udhërrëfyes për fazat e ardhshme të zhvillimit të Fakultetit tonë.

VIZIONI

Vizioni i Fakultetit të Ndërtimtarisë është në përputhje të plotë me vizionin e Universitetit të Prishtinës. Fakulteti është njësi akademike e UP-së dhe si institucion i lartë i arsimit është i njohur me veprimet e saja profesionale, mësimdhënie cilësore dhe hulumtim.

Vizioni jonë si institucion i lartë i arsimit është përsosja e aktiviteteve në mësimdhënie dhe mësim nxënie duke siguruar plasman të kuadrit i cili do të jetë i përgatitur të i përgjigjet më së miri kërkesave të trendëve të zhvillimeve shkencore dhe inxhinierike.

Përcjellja e arritjeve shkencore, zhvillimit të fushave të inxhinierisë së ndërtimit në shkallë ndërkombëtare do të jenë detyra parësore për stafin akademik, studentët dhe institucionin. Hulumtimet shkencore janë vizion i rritjes së kapaciteteve akademike dhe institucionale.

MISIONI

Misioni i Fakultetit të Ndërtimtarisë mbështetet në Misionin e Universitetit të Prishtinës. Për të përmbushur misionin e tij Fakulteti mbështetet në Statutin e UP-së, aktet tjera normative e ligjore në fuqi si dhe në rregulloret e brendshme.

Misioni i Fakultetit është, arsimimi, përvetësimi i njohurive, aftësive, vlerave, përgatitja shkencore dhe profesionale e kuadrove në fushat e Inxhinierisë së Ndërtimit për avancim të mëtejshëm hulumtues, shkencorë si dhe për tregun e punës si vendor ashtu edhe ndërkombëtar.

Për përmbushjen e misionit të FN-së si njësi akademike e UP-së, angazhohet menaxhmenti, personeli akademik, administrata dhe studentët duke siguruar ambiente dhe kushte që studentët të arrijnë aftësitë sipas programeve të studimeve duke respektuar rregullat dhe parimet e hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Arritja e misionit të FN-së kërkohet përmes:

- Rritjes së vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Freskimit të vazhdueshëm të programeve të studimeve të ofruara.
- Avancimi i kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore në nivele ndërkombëtare.
- Ngritja e kapaciteteve të Laboratorëve për fushat profesionale shkencore.
- Rritjes së cilësisë për shërbimet e studentëve.
- Përmirësimit dhe rritjes së kapaciteteve të stafit akademik dhe ambienteve të mësim.
- Promovimi dhe rritja e standardeve të cilësisë për programet e studimeve.

Fushë veprimtaritë e Fakultetit, janë zhvillimi i aktiviteteve Akademike, mësimdhënia, hulumtimet shkencore dhe të tjera, të mbështetura në programet e akredituara të studimeve në fushat e inxhinierisë së Ndërtimit për nivele Bachelor dhe Master shkencore dhe profesional sipas procesit të Bolonjës.

Ndërkombëtarizimi i Fakultetit përmes pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, bashkëpunimi i ndërsjellë me institucionet relevante në projektet hulumtuese, publikimet shkencore në revista

kredibile, kongrese dhe konferenca ndërkombëtare, mobiliteti i mësimdhënësve dhe studentëve janë përkushtime të përhershme të Institucionit.

Qëllimi i veprimeve institucionale, përputhet me misionin edhe përmes aktiviteteve, përkatësisht programeve të studimit të tij që mëton arritjet më të larta shkencore dhe profesionale duke qenë lider në fushat e inxhinierisë së ndërtimit.

Fakulteti i Ndërtimtarisë është institucion publik autonom i arsimit të lartë që zhvillon arsimin akademik, hulumtime shkencore, këshillime profesionale dhe akademike. Duke respektuar ligjet aktuale të Kosovës, Statutin e Universitetit, Fakulteti ka për qëllime:

- Të veproj si institucion autonom lidhur me udhëheqjen dhe avancimin e dijes. Krijimin dhe avancimin e Ideve të reja kreative me bazë shkencore dhe praktike për nevojat e tregut të punës.
- Përkushtim në punë kërkimore dhe akademike të stafit akademik dhe Studentëve për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien si proces i vazhdueshëm institucional.
- Avancimi i krijimit të njohurive shkencore, shkathësive profesionale dhe analitike, kreativitetit dhe aftësive të ndërlidhura të mësimdhënësit.
- Fokusimi Evropian dhe Ndërkombëtar në fushat e Inxhinierisë së ndërtimit, përkatësisht Strukturave, Hidroteknikës, Gjeodezisë, Inxhinierisë së mjedisit dhe infrastrukturës që të i sigurojmë studentit dhe stafit akademik lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në kualifikimet dhe diplomat e arritura.
- Krijimi i kushteve dhe mundësive të pa penguara për zhvillimin dhe avancimin e aktiviteteve akademike për mësimdhënie të avancuar dhe hulumtime shkencore të stafit akademik.
- Angazhimi aktiv i studentëve si në aspektin individual ashtu edhe kolektiv në jetën e aktiviteteve të Fakultetit, përkatësisht zhvillimit të programeve të studimeve dhe në mësimnxënien e tyre.
- Zhvillimi dhe avancimi i programeve të studimeve të fushave të Ndërtimtarisë, përkatësisht të Strukturave – ndërtimit, Gjeodezisë, Hidroteknikës dhe Inxhinierisë së mjedisit dhe Infrastrukturës duke u mbështetur në arritjet shkencore dhe arsimore në Evropë dhe Botë.
- Përmes bashkëpunimit ndërkombëtarë të integrohemi plotësisht në zonën Evropiane të arsimit të lartë, përmes kërkimeve shkencore dhe aktiviteteve tjera akademike të institucionit tonë.

Fakulteti i Ndërtimtarisë i themeluar që nga viti 1961 ka përvojën më të gjatë në vend në ofrimin e arsimit të lartë. Në kuadër të FN-së ekzistojnë katër departamente të cilat korrespondojnë me fushat e studimeve përkatëse me programe studimore të veçanta të nivelit Bachelor dhe Master shkencor. FN-ja, ka Departamentet:

- Konstruksioneve,
- Hidroteknikës,
- Gjeodezisë, dhe
- Inxhinierisë së Ambientit

Funksionimi i departamenteve, nënkupton përfshirjen e gjerë në pjesëmarrje të stafit akademik në kontributet akademike, mësimdhënie, mësimnxënie, proceset e vlerësimeve të projektpropozimeve dhe punimeve të diplomave deri te propozimet për Këshillin e Fakultetit përkatësisht Dekanit. Brenda Fakultetit funksionojnë Laboratorët e materialeve ndërtimore, asfaltit, gjeomekanikës, gjeodezisë, hidroteknikës, ambientit dhe nën krijim e sipër laboratorit i strukturave.

Në FN organizohen dhe zhvillohen programe të studimeve të niveleve BSc dhe MSc. Programet e studimeve të klasifikuara të FN-së në Departamente dhe nivele janë sikur:

- Konstruktiv (BSc), dhe (MSc)
- Hidroteknikë (BSc), (MSc)
- Gjeodezi (BSc), (MSc), dhe
- Inxhinieri e Ambientit (BSc)

Niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, ky nivel krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht të transferueshme në disiplina të përafërta.

Diversiteti i programeve të studimeve në fushat teknike të ndërtimit, nevojat e tregut të punës për njerëz të kualifikuar paraqesin sfida për të siguruar zhvillim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë së institucionit tonë.

Ndryshimet në funksionim e Fakultetit konsiderohen të nevojshme dhe të menjëhershme duke krijuar mekanizma shtesë të kontrollit të cilësisë, burimeve njerëzore, e-karriera, Alumni dhe të tjera. Kjo strategji e institucionit do të përshkruaj qëllimet e arritjes së Fakultetit dhe programeve të studimeve në avancimin e aktiviteteve institucionale, mësimdhënie, mësimnxënie, hulumtime shkencore dhe shërbime efektive për studentët duke respektuar standardet e institucioneve vendore dhe rekomandimeve ndërkombëtare.

Për përmbushjen e qëllimeve të avancuara institucionale përveç tjerash do të nevojitet edhe rritja e kapaciteteve të infrastrukturës së Fakultetit.



Për të arritur qëllimet tona ne na duhet të jemi ambicioz dhe strategjik në zhvillimin e brezave të ri të vendit tonë duke menaxhuar burimet tona në mënyrë efikase si dhe duke bashkëpunuar për realizimin e ideve për avancimin dhe përsosjen e aktiviteteve tona institucionale.

Risite në edukim të cilat do të avancojnë të diplomuarit e rinj të cilët mund të përparojnë shpejt në avancimet dinamike të botës.

- ✓ Rritja e praktikës së studenteve.
- ✓ Organizimi i punës me studentet dhe stafin akademik të Fakultetit për zhvillimin e temave/problematikave të ndryshme akademike, shkencore si dhe funksionale të njësisë sonë.
- ✓ Pjesëmarrja e studenteve në projekte të përbashkëta me stafin akademik do të jetë në fokus për rritjen e cilësisë së studimeve.
- ✓ Organizimi periodik i vizitave studimore me studentet brenda dhe jashtë vendit me qëllim të zhvillimit akademik, kulturor dhe institucional.

Zhvillimi i strukturave, përmbajtjes dhe modelit të portofolit tonë për programet studimore të ofruara për studentët rinj dhe studentët e studimeve master si dhe kërkesat ardhshme të tregut të punës:

- ✓ Prezantimi i Fakultetit në institucione të vendit dhe jashtë vendit përmes bashkëpunimeve të ndërsjella.

Angazhimi jonë për rritjen e diversitetit të programeve studimore (shkencore ose/dhe profesionale) të fushave të ndërtimit përmes iniciativave të departamenteve:

- ✓ Trupa këshillëdhënëse dhe Alumni do të jenë motivuese për kërkesat e programeve të ndryshme studimore nga tregu i punës.

Rritja e kapaciteteve për kërkimet shkencore përmes bashkëpunimeve institucionale ndërkombëtare, rritja e numrit të stafit akademik me tituj shkencore Doktor:

- ✓ Organizimi i Simpoziumeve shkencore, punëtori për problematikat shkencore pjesëmarrja ne projekte te përbashkëta me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.
- ✓ Trajnimi i stafit akademik përmes programeve Erasmus +, Jane Mone si dhe trajnime interne (te brendshme).

Zhvillimi i qëndrueshëm i performancave të programeve të studimeve duke rritur numrin e studentëve në fakultetin tonë:

- ✓ Organizimi i fushatave për sensibilizimin e studenteve te ardhshëm
- ✓ Publikimi i broshurave njoftuese
- ✓ Njoftimi ne kohe për përmbajtjen e programeve te studimeve – ne faqen elektronike te Fakultetit
- ✓ Informatat dhe kërkesat ne kohe reale nga tregu i punës për performancën e programit te studimit.

Pozicionimi i institucionit tonë si lider i zhvillimit të fushave teknike të ndërtimit për vendin tonë:

- ✓ Mbështetja Institucioneve vendore përmes konsultave profesionale
- ✓ Ndhurma shkencore ne zgjedhjen e problemeve inxhinierike te subjekteve nga tregu i punës
- ✓ Organizimi i punëtorive për çështje te interesave te përgjithshme te vendit.

Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i infrastrukturës; përkatësisht rritja e numrit të ulëseve në bibliotekën e fakultetit, laboratorët, hapësirat e përbashkëta dhe sallat e mësimi.

Të rrisim përpjekjet për ndërkombëtarizimin tonë. Anëtarësimi i Fakultetit ne FIB, RILEM, ACI.

PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE DHE INICIATIVAVE STRATEGJIKE

Në përputhje me misionin dhe vizionin e vet, Fakulteti i Ndërtimtarisë ka identifikuar një numër të objektivave strategjik, me qëllim që të avancoj pozitën konkurruese përmes ofrimit të shërbimeve cilësore. Duke u mbështetur në kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore, janë përcaktuar prioritetet sikur në vijim:

Rritja e cilësisë në arsim dhe kërkim shkencore

Ndërtimi i mekanizmave të nevojshme brenda Institucionit për mundësitë e zhvillimit dhe arritjeve të standardeve ndërkombëtare. Brenda organeve kolegiale të Fakultetit, personelit akademik, administratës do të promovohet filozofia e vlerësimeve, vetëvlerësimeve dhe llogaridhënia për aktivitetet e çdo të punësuar pa asnjë dallim. Vlerësimet e studentëve, vlerësimet nga studentët, vetëvlerësimi i stafit akademik dhe administrativ do të jetësohen dhe do të bëhen publike në rrugët zyrtare të Fakultetit.

Stafi akademik i Fakultetit do të mbështetet për kërkimet shkencore. Brenda Fakultetit do të ndërtohet trupa këshilluese e cila do të kontribuoj në inkurajimin, informimin dhe këshillimin për realizimin e hulumtimeve shkencore të stafit. Përmes bashkëpunimeve me institucionet arsimore ndërkombëtare do të ofrojmë mundësi për kërkime të avansuara.

Trajnimi i stafit në mësimdhënie të avancuar do të jetë proces i vazhdueshëm i Universitetit, njësisë akademike për avancimin në mësimdhënie.

Zhvillimi i programeve të studimeve duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës, konkurrencës globale do të zhvillohet përmes krijimit të bordit industrial si dhe Alumni-t të FN-së. Informatat kthyese nga banka e shënimeve nga tregu i punës do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të programeve të studimeve.

Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi

Fakulteti i Ndërtimtarisë, në lidhje institucionale me Universitetin për qëllime të arritjeve sa më të larta në fushat e kërkimeve shkencore do të angazhohet në arritjen e bashkëpunimeve bilaterale të institucioneve akademike, shkencore dhe hulumtuese.